


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2021

Tiranë, më 25 Janar 2022: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar, në muajin Dhjetor 2021, është 667.432 dhe krahasuar me Dhjetor 2020, ky tregues rezulton me rritje 50,7 %. Në Dhjetor 2021, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 267.409, krahasuar me Dhjetor 2020, ky numër është rritur me 47,9 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Dhjetor 2021




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 5.688.649, duke u rritur me 2,1 herë, në krahasim me vitin 2020. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në vitin 2021, është 4.190.786, duke u rritur 44,2 %, krahasuar me vitin e mëparshëm (tab1).

Gjatë vitit 2021, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe me 4,6 herë, Spanja me 4,5 herë dhe SHBA me 3,9 herë, krahasuar me vitin 2020 (tab.2).

Fig. 2 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, 2020 – 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2021 janë 342.909. Krahasuar me Dhjetor 2020, ky numër është rritur 59,0 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2021, janë 279.987. Krahasuar me Dhjetor 2020, ky numër është rritur 79,5 %.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Dhjetor 2021

Periudha	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	442.966	667.432	50,7	5.419.417	9.616.679	77,4
Shqiptarë	262.151	400.023	52,6	2.761.599	3.928.030	42,2
Të Huaj	180.815	267.409	47,9	2.657.818	5.688.649	114,0
Dalje Gjithsej	371.671	622.896	67,6	5.543.892	9.622.826	73,6
Shqiptarë	215.698	342.909	59,0	2.906.828	4.190.786	44,2
Të Huaj	155.973	279.987	79,5	2.637.064	5.432.040	106,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj, Dhjetor 2021

Shtetet	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021
Kosovë	85.648	78.271	1.379.360	2.640.447
Maqedonia e Veriut	31.826	31.738	370.135	560.213
Greqi	5.714	34.835	203.445	276.915
Itali	9.648	31.597	123.489	354.370
Angli	3.849	8.545	53.402	89.624
Mali i zi	18.746	25.632	174.233	319.770
Poloni	317	748	24.404	112.223
SHBA	2.070	4.523	24.570	95.377
Spanjë	188	875	2.801	12.567
Gjermani	3.252	5.395	39.461	119.009
Zvicër	3.466	2.850	18.388	57.011
Të tjera	16.091	42.400	244.130	1.051.123
Gjithsej	180.815	267.409	2.657.818	5.688.649

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Dhjetor 2021

Periudha	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	180.815	267.409	47,9	2.657.818	5.688.649	114,0
I. Personale	170.162	258.423	51,9	2.542.494	5.588.400	119,8
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtime shëndetësore, etj.	155.022	244.075	57,4	2.458.883	5.413.095	120,1
2. Qëllime fetare	28	21	-25,0	326	488	49,7
3. Udhëtarë transit	15.112	14.327	-5,2	83.285	174.817	109,9
II. Biznes dhe profesionale	10.653	8.986	-15,6	115.324	100.249	-13,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Dhjetor 2021

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Dhjetor 2020	50.816	28.666	363.484	33.749	10.566	327.356
Dhjetor 2021	151.120	47.591	468.721	115.288	16.463	491.145
Ndryshimi vjetor (%)	197,4	66,0	29,0	241,6	55,8	50,0
Janar-Dhjetor 2020	657.467	233.538	4.528.412	649.044	223.890	4.670.958
Janar-Dhjetor 2021	1.457.497	494.985	7.664.197	1.443.841	445.517	7.733.468
Ndryshimi vjetor (%)	121,7	112,0	69,2	122,5	99,0	65,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.